



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë

**Titulli:**

Qendra “Nūn” për Shkrime dhe Përkthime

**Përktheu nga anglishtja:**

Mentor ÇADRI



Centre International  
de Traduction et de Publication  
Islamique Al-Mustafâ - Qom

پیش به سوی جامعه آرمانی. آلبانیایی.	عنوان قراردادی:
Vendosja e shoqerise ne rruge te drejte	عنوان و نام پدیدآور:
	مشخصات نشر:
Almustafa International Translation and Publication center 1393 = 2014	
مرکز بین المللی ترجمه و نشر ﷺ؛ پ ۲۵۸/۳۷۶/۱۳۹۳.	فروست اصلی:
نمایندگی آلبانی، ۱۶.	فروست فرعی:
۹۷۸-۹۶۴-۱۹۵-۵۸۵-۶	شابک:
فیپای مختصر	وضعیت فهرست نویسی:
این مدرک در آدرس <a href="http://opac.nlai.ir">http://opac.nlai.ir</a> قابل دسترسی است.	یادداشت:
چادری، منتور، مترجم	شناسه افزوده:
Cadri, Mentor	شناسه افزوده:
مرکز نون للتألیف والترجمة	شناسه افزوده:
Markaz Nūn lil-Ta'lif wa-al-Tarjamah	شناسه افزوده:
جامعه المصطفی ﷺ العالمية مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ	شناسه افزوده:
Almustafa International University Almustafa International	شناسه افزوده:
Translation and Publication center	
۳۷۶۶۰۵۹	شماره کتابشناسی ملی:

**Titulli: Vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë**

**Autori: Qendra "Nūn" për Shkrime dhe Përkthime**

**Përktheu Nga Anglishtja: Mentor ÇADRI**

**Redaktoi: Jetmir ÇELA**

**Paraqitja Grafike: Fatmir SHUTINA**

**Botoi: Al-Mustafa International Publication And Translation Center**

**Tiranë: 2015**

**ISBN: 964-195-585-6**

مرجع تولید: مرکز نور

مترجم: منتور چادری

چاپ اول: ۱۳۹۳ ش / ۲۰۱۵ م

ناشر: مرکز بین المللی ترجمه و نشر المصطفی ﷺ

● چاپ: نارنجستان ● قیمت: ۶۵۰۰۰ ریال ● شمارگان: ۳۰۰ نسخه

● IRAN, Qom; Muallim avenue western , (Hujjatia). Tel-Fax: +98 25-37839305 - 9

● IRAN, Qom; Boulevard Muhammad Ameen, Y-track Salarayah. Tel: +98 25-32133106, Fax: +98 25-32133146

## Pasqyra e lëndës

Fjalor.....	6
Parathënie.....	11
<b>Kreu i parë:</b>	
Shoqëria më e mirë.....	14
Arsyeja që qëndron pas zemërimit të madh të Allahut.....	14
Kushti për arritjen e suksesit të madh.....	17
Individi me devotshmëri të fortë.....	17
Vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë.....	18
<b>Kreu i dytë:</b>	
Akti i urdhërimit për vepra të mira dhe ndalimit prej veprave të këqija. Çfarë është?.....	22
Kur është i detyrueshëm?.....	23
1. Të nxënit dhe dituria.....	24
2. Mundësia për të patur ndikim.....	26
3. Të qenit i sigurt nga çdo e keqe.....	27
4. Këmbëngulja për vazhdimësi.....	29

A përbën ndershmeria një kusht?.....	30
Asnjë neglizhim apo shfajësim.....	31
Kush e kryen këtë detyrë?.....	32
Si kryhet kjo detyrë?.....	34

**Kreu i tretë:**

Nxitësit e shthurjes.....	40
Natyra e njeriut dhe egoizmi.....	40
Shkatërrimi i njeriut.....	43
Sthurja intelektuale.....	44
Mjetet e shthurjes.....	45
1. Mjetet e komunikimit.....	46
2. Arti i devijuar.....	46
3. Qendrat e shthurjes.....	47
4. Femra e devijuar.....	47
5. Imitimi i Perëndimit.....	49
Përballja me shthurjen.....	51
1. Gjerësia e konfrontimit.....	51
2. Përballja me shthurjen sapo shfaqet.....	52
3. Shkatërrimi i nxitësve të shthurjes.....	52

**Kreu i katërt:**

Bazat e drejtësisë.....	56
1. Vetëformimi.....	56
2. Rëndësia e kultures.....	57
3. Forcimi i anës shpirtërore.....	58
Taktikat e reformimit.....	59
1. Përpjekjet e vazhdueshme.....	59
2. Vetëbesimi.....	59
3. Kërcënimi dhe joshja.....	60
4. T'i kushtohet vëmendje brezit të ri.....	60
5. Media.....	61
Aktivizimi i aktiviteteve të shenjta përkujtimore.....	62
Konkluzione.....	65



## Fjalor:

*Akt i obligueshëm (vaxhib):* duhet të kryhet; duke e bërë atë, bërësi arrin kënaqësinë e Allahut, në të kundërtën, do të pasojë ndëshkimi.

*Akt shumë i rekomanduar (mustehab):* duhet kryer, por Allahu lejon heqjen dorë prej tij, dhe në këtë mënyrë nuk ka ndëshkim si pasojë.

*Akti i lejuar (mubah):* Allahu nuk ka kërkuar kryerjen apo heqjen dorë prej tij.

*Akt i ndaluar (muharram):* Allahu e ka ndaluar kryerjen e tij, në të kundërtën, të pret Zjarri dhe ndëshkimi hyjnor, sidomos në Jetën e Përtejme.

*Akt tejet i padëshirueshëm (mekruh):* Allahu e ka ndaluar kryerjen e tij, por nëse bëhet, nuk do të jetë i nevojshëm Zjarri apo ndonjë ndëshkim hyjnor.

*Akti i urdhërimit për vepra të mira dhe ndalimit prej veprave të gabuara (el-emr bi'l-ma'ruf wa al-nehj 'anil-munker):* Është e detyrueshme t'u kërkohej njerëzve të kryejnë zakonet e detyrueshme dhe të heqin dorë nga veprat e ndaluara. Ndërkohë, u rekomandohet atyre të kryejnë vepra shumë të vyera dhe të braktisin veprat tejet të padëshirueshme. Me pak fjalë, këto dy procese të përmendura më sipër, janë

quajtur akti i urdhërimit për kryerjen e veprave të mira dhe i ndalimit ndaj kryerjes së veprave të këqija.

*Mosha e obligimit/detyrimit (sinnu't-teklif)*: mosha kur dispozitat islame bëhen të detyrueshme për vajzat dhe djemtë myslimanë - sipas kalendarit hixhri ajo është 9 vjeç për vajzat dhe 15 për djemtë. Sipas kalendarit AD (pas erës sonë), ekuivalenti është 8 vjet e 9 muaj për vajzat dhe 14 vjet e 7 muaj për djemtë. Djemtë, gjithashtu, duhet të marrin në konsideratë shenjat e tyre të pjekurisë seksuale të përmendura në librat e jurisprudencës.

*Myslimani i obliguar (al-mukel'lef)*: vajza myslimane që arrin moshën 9 vjeç dhe djali mysliman që arrin moshën 15 vjeç (sipas kalendarit islamik hixhri)

*Shpirti, jetën e të cilit Allahu e ka bërë të paprekshme (en-nefsu'l-muhterame)*: është e ndaluar të vrasësh shpirtin që Allahu e ka bërë të paprekshëm.

*Obligimi është i anuluar (rufi'at-teklif)*: kur obligimi anulohet dhe detyra nuk është më e nevojshme.

*Dëshmi rekomandimi dhënë nga dy njerëz të ndershëm (shehadetu'l-'adlejn)*: sipas përcaktimit islam, personi i drejtë është ai, i cili është i njohur për bindjet e tij ndaj dispozitave apo ligjeve islame.



*Gjendje që është pothuajse e ndaluar (vuxhubu'l-kerahije):* vepër që është krejtësisht ose pjesërisht e ndaluar, pa qenë e ndaluar në të vërtetë.

*Pjesërisht e detyrueshme (vaxhib kifa'i):* në qoftë se një grup njerëzish është duke kryer me aftësi këtë detyrë, atëherë të tjerët nuk janë të detyruar më për të kryer këtë detyrë, por, në qoftë se performanca e tyre është nën nivelin e duhur apo e pamjaftueshme, atëherë është detyrë e çdo personi të përfshihet dhe ta kryejë atë; përndryshe, gjithkush do të konsiderohet si mëkatar për neglizhimin e një detyre të tillë.

*Shkalla e të lehtës dhe shumë të lehtës:* njeriu duhet të marrë në konsideratë çështjen me të cilën merret dhe të vazhdojë ta trajtojë në rritje graduale, në atë masë që, nëse mënyra më e lehtë dhe më pak e ndikueshme do të ishte e mundur, atëherë vetëm ajo masë do të ishte e mjaftueshme.

E njëjta gjë duhet thënë këtu, në gjykimin dhe zgjedhjen e mënyrave të menaxhimit të çështjeve që kemi në dorë për shqyrtim, p.sh. duke i trajtuar në rritje graduale. Atëherë, në qoftë se mënyrat më të sjellshme të shprehjes do të ishin më me ndikim, atëherë nuk do të ishte e nevojshme të përdornim fjalë të ashpra ose tone të forta dhe të bërtitura apo mënyra të tjera të të folurit.

*Hixhabi:* shamia e kokës.

*Ummeti:* shoqëria myslimane.

*Sprova (el-bela')*: provë apo përvojë, gjatë së cilës personi duhet të jetë i kujdesshëm dhe me durim për të mos u përfshirë në kryerjen e ndonjë mëkati.

*Njeriu që është në provë (mubtela)*: personi që është duke kaluar një sprovë të caktuar ose përvojë që kërkon durim, vëzhgim dhe mbikëqyrje të kujdesshme.

*Palloi i melekëve (Tawus al-Mala'ika)*: Shejtani ka qenë palloi i melekëve (për shkak të adhurimit të tij, edhe pse ishte xhind) përpara se të bëhej kundërshtar i All-llahut, pra, armiku i Tij.

*Dispozitat ndëshkimore islame (el-hudud)*: Caqet dhe dënimet që Islami ka vendosur për të vënë rendin në shoqëri.

## **Parathënie**

Shprehja “vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë” është përkthimi praktik i udhëzimeve të vendosura nga të gjithë profetët dhe kujdestarët e Allahut, të cilët kanë duruar të gjitha llojet e punëve të rënda për të udhëzuar publikun, kanë duruar torturat, xihadin dhe konfrontimin me të gjithë shtypësit, në të gjitha kohërat. Vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë është proces, që patjetër do të çojë në momentin kur e tërë drejtësia hyjnore do të përhapet në çdo kënd botës. Ky moment është ëndrra që ka pushtuar mendjet e njerëzve të devotshëm. Por, kjo ëndërr duhet të shoqërohet me përpjekje të shumta e të vështira, në të kundërt, do të ishte një lloj vetëmashtrimi. Përhapja në të gjithë botën e praktikave të tilla të drejta është qëllimi më madhor që duhet të ndiqet nëpërmjet aktit të urdhërimit të veprave të mira dhe ndalimit prej veprave të shëmtuara dhe të kundërligjshme; duke qenë i aftë për të kryer këtë akt, në veçanti, është një sukses që garantohet vetëm nga Allahu, i Pagabueshëm dhe i lartësuar është Ai. Kjo ëndërr, thuhet që të manifestohet kur shoqëria bëhet e përsosur dhe plot vlera njerëzore, dhe kur shoqëria garanton lumturinë e njeriut në të dy botët – në këtë botë dhe në në botën e përtejme.

Qendra 'Nūn' për Shkrime dhe Përkthime ka nderin të publikojë libërthin "Vendosja e shoqërisë në rrugë të drejtë", i cili prezanton mendimin e Imam Ruhullah Al-Musavi Al-Khomeini. Imam Khomeini është lideri që mund të prezantohet plotësisht në moshën e tij për vënien në dukje të korrupsionit e çoroditjes, kudo që shfaqej, duke paralajmëruar publikun për mënyrat e qëllimet mashtrimit, dhe duke i drejtuar ata të përballen me situata të korruptuara, hapur dhe qartë me mjetet më të përshtatshme. Kjo broshurë është botuar për të vënë në praktikë çdo ditë fjalët e Imamit, në mënyrë që të përmbushë detyrën siç duhet në shoqërinë tonë për të urdhëruar për vepra të mira, apo atë që është e drejtë, dhe për të ndaluar prej veprave të shëmtuara, apo atë që është e gabuar...

**Qendra Nūn' për shkrime dhe përkthime**